

# RAPORT PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS



## “Linje fraksionim inertesh dhe prodhim betoni”

**SUBJEKTI :** “Korabi 2007” sh.p.k

**ADRESA :** Fshati Cerkez-Marines, Komuna Zall-Herr, Tirane

Ekspert i Mjedisit Ing. Hysen Doçi

**Përmbajtja:****1. Hyrje****2. Përshkrimi i projektit**

Njohuri të përgjithëshme mbi aktivitetin

Vendndodhja e objektit

**3. Përshkrimi fizik i zonës**

Klima

Gjeomorfologjia

Rezervat ujore

Tokat

Biodiversiteti

Flora

Bimësia ujore

Bimësia e shkurretave mesdhetare

Fauna

**4. Të dhëna mbi procesin e prodhimit të betonit dhe fraksionimin e inerteve.**

Proçesi teknologjik

Mbetjet teknologjike

Infrastruktura inxhinjerie

Energjia dhe burime të tjera për konsum

Sigurimi teknik i objektit dhe i punonjësve

**5. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis i aktivitetit të prodhimit,veshje dhe modelim divanash.**

## **6. Ndikimet e mundshme në mjedis**

### **7. Masat zbutëse**

Sistemi kundër zjarrit

Mbetjet

Ndotja nga karburantet

Zhurmat

Gjelbërimi

Kanalizimet

Përdorimi eficient i ujit dhe energjisë

Masat mbrojtëse për punonjësit

### **8. Programi i monitorimit**

### **9. Konkluzione**

## 1. Hyrje

Ky projekt ka si qëllim kryesor të tij, vlerësimin e ndikimit në mjedis të aktivitetit “ Linje fraksionim inertesh dhe prodhim betoni” ne fshatin cerkec-marines, komuna Zall-Herr, Tirane.Te sigurojë marrjen në konsideratë në të gjitha nivelet e faktorëve mjedisorë që kërkohen në Ligjin “ Për Mbrojtjen e Mjedisit “ Subjekti Korabi 2007 “ sh.p.k i regjistruar ne QKR me NIPT K 71523008 G me veprimtari ne fushen e ndertimit te te gjitha llojeve.

Nder ligjet e legjislacionit ne Republiken e Shqiperise ne lidhje me Mjedisin, per nje Raport te Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis dhe mjedisin përreth projektit përfshijnë :

- Ligji Nr 10448 per Lejet e Mjedisit, date 14 korrik 2011.
- Ligji Nr 8906 për Zonat e Mbrojtura, date 6 Qershor 2002.
- Ligji Nr 7665 për zhvillimin e Zonave me Prioritet per Turizmin, date 21 Janar, 1993.
- Ligji Nr 8905 për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Demtimi, date 6 Qershor 2002.
- Ligji Nr 9010 për Administrimin Ambientalist te Mbeturinave te Ngurta, date 13 Shkurt 2003.
- Ligji Nr. 9108 per Substancat dhe preparatet kimike date 17.7.2003
- Ligji Nr 10431 per Mbrojtjen e Mjedisit date 9.6.2011.
- Ligji Nr10081 per Licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise.date 23.2.2009.
- Ligji Nr 8094 për Largimin e Mbeturinave Publike, date 21 Mars, 1996.
- Ligji Nr 7875 për Gjuetine dhe Mbrojtjen e Kafshëve te Egra, date 23 Nentor, 1994.
- Ligji Nr 7929 për Mbrojtjen e Drureve Frutore date 11 Maj, 1995.
- Ligji Nr 7908 për Peshkimin dhe Akuakulturat, date 5 Prill, 1995.
- Ligji Nr 7917per Kullotat dhe Livadhet, date 13 Prill,1995
- Ligji Nr 8405 për Urbanistikën, date 17 Shtator 1998 dhe amendamentet e mëpasme
- Ligji Nr 8053 Për te Drejten e Informimit mbi Dokumentet Publike, date 30 Qershor 1999.

Ekspert i Mjedisit Ing. Hysen Doçi

- Ligji Nr 8652 Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverive Lokale, date 31 Korrik 2000.
  - Ligji nr.9537, dt 18.05.2006 “Per administrimin e mbetejeve te rrezikshme”
  - Vendimi nr.103,dt 31.07.2002 “Per monitorimin e Mjedisit ne Republiken e Shqiperise”.
  - Vendimi nr.805,dt 04.12.2003 “Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkojne Leje Mjedisore”.
  - Vendimi nr.177,dt 31.03.2005 “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret”
  - Udhzim i Ministrise se Mjedisit Nr. 3 date 02 dhjetor 2013.
  - Udhzim i Ministrise se Mjedisit nr. 3, dt 17.08.2004 “Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe te zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollimit te tyre”.
  - Udhzim i perbashket; Ministria Mjedisit dhe Ministria e Shendetsise nr.8, dt 27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara “.
  - Udhzimi Nr. 5, “Per Tarifat e Sherbimit per Leje Mjedisore“ date 25.12.2007.
  - VKM nr 587 date 07.07.2010 ,”Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane e turistike”
  - Udhzim nr 2 date 25.05.2011 “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”.
  - Ligji nr.9537, dt 18.05.2006 “Per administrimin e mbetejeve te rrezikshme”
  - **Udhzimi nr.3 date 02.12.2013,”Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A,B dhe C per aktivite te reja dhe ekzistuese”.**
- Projektet publike dhe private te personave fizik dhe juridik, vendas ose te huaj, qe kerkojne te ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe mund te ndikojne ne Mjedis, i nenshtrohen ne pregatitjen e nje Raporti te permbledhur te Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis, perpara miratimit dhe zbatimit te tyre.
- Raporti i permbledhur te Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis perfshin indentifikimin, sakesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis.

Leja e tipit “B” e parashikuar ne ligjin Nr. 10448/2011, trajtohet si Leje mjedisore me kodin III.1.A e parashikuar ne aneksin I, te V.K.M. Nr. 53, date 26.05.2009” Licensat dhe Lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL

Në këtë projekt japim konsideratat mjedisore për aktivitetin që do të kryhet, që të orientojmë institucionet dhe organet vendim marrëse në dhënien e miratimit të Lejes Mjedisore tipit “B” për të kryer këtë aktivitet.

Me këtë relacion sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Zbatimi i këtij projekti plotëson kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

Ky projekt ka si qëllim kryesor të tij, vlerësimin e ndikimit në mjedis të aktivitetit të prodhimit të betonit dhe prodhimit të inerteve qe sherbejne si lende e pare per betonin. të sigurojë marrjen në konsideratë në të gjitha nivelet e faktorëve mjedisore që kërkojnë në Ligjin “ Për Mbrojtjen e Mjedisit “. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis u porositi nga investitori për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për t’u pajisur me Leje Mjedisore nga Agjensia Kombetare e Mjedisit Tirane. Raporti është përgatitur në zbatim të Ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 04.12.2003 “Për Miratimin e Listës së Veprimtarive që Ndikojnë në Mjedis, për të cilat kërkohet Leje Mjedisore”, si dhe akteve normative të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.Udhezimit Nr.4 date 15.04.2013 “ Per dokumentacionin e aplikimit per Leje Mjedisit te tipit A,B,dhe C ne Qendren Kombetare te Licensimit ( Q.K.L.)”

Në këtë projekt japim konsideratat mjedisore për aktivitetin që do të kryhet, që të orientojmë institucionet dhe organet vendim marrëse në dhënien e miratimit të Lejes Mjedisore për të kryer këtë aktivitet.

Me këtë relacion sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Zbatimi i këtij projekti plotëson kërkesat e mbrojtjes së mjedisit

## 2. Përshkrimi projektit

### 2.1 Njohuri të përgjithshme mbi aktivitetin

Shoqëria “ **Korabi 2007**” Sh.p.k. merret me Prodhimin e betonit dhe prodhimin e inerteve per beton, që nga viti 2007. Meqënëse është e domosdoshme marrja e lejes mjedisore, shoqëria “**Korabi 2007**” Sh.p.k. ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik që i bashkangjitet raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe është në pritje të miratimit të saj.

Sheshi industrial ku zhvillon aktivitetin shoqëria “ **Korabi 2007**” Sh.p.k. është prone private e Z. Shkelqim Kupa sipas Çertifikates se leshuar nga Zyra e Regjistrimit te Pasurve te pa Luajtshme.

Siperfaqja e Sheshit te ndertimit ku jane vendosur Linja e Betonit dhe linja e inerteve **4999 m2** dhe ka keto kordinata:

Nr	Kordinatat	
	X	Y
1	45 85 330	43 97 360
2	45 85 360	43 97 410
3	45 85 440	43 97 350
4	45 85 410	43 97 310

Ky aktivitet e siguron energjine elektrike nga linjë e veçantë që ka mundësuar CEZ, nga një kontratë e lidhur me këtë shoqëri. Energjia elektrike nuk ndërpritet kurrë në këtë objekt. Energjia elektrike e shpenzuar nga objekti nuk ndikon në linjën e banorëve të zonës.

## **2.2 Vendndodhja e objektit**

Linja per prodhimin e betonit dhe linja e inerteve ndodhen ne fshatin Cerkez-Marines,Komuna Zall-Herr,Tirane.

<b>Sipërfaqja e objektit industrial</b>	<b>4999 m<sup>2</sup></b>
<b>Linja e Betonit</b>	<b>1000 m<sup>2</sup></b>
<b>Linja e inerteve</b>	<b>1400 m<sup>2</sup></b>
<b>Ambjente ndihme ( zyra+magazina,dhomaticveshje,servis etj)</b>	<b>200 m<sup>2</sup></b>







Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjrike është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin shoqëria “ **Korabi 2007**” Sh.p.k. janë:

- Linja Industriale është i ndërtuar në një vend strategjik për zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të betonit dhe fraksionimit të inerteve.
- Linja industriale ndodhet afër rrugës nacionale Tirane-Shkoder, një zonë industriale dhe nuk dëmton banorët e zonës.
- Ekziston infrastruktura e nevojshme: rrugë, energji, ujë, sistem kanalizimesh, etj.
- Është në aks rrugor kombëtar dhe ndërkombëtar

### 3. Përshkrimi i mjedisit fizik të zonës

#### 3.1 Klima

Në zonën ku do të do të zhvillojë aktivitetin e saj shoqëria “ **Korabi**” Sh.p.k., klima është tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë.

Në këtë zonë mbizoterojnë erërat e veriut dhe me drejtim nga veri – perëndimi për në jug – lindja, me shpejtësi mesatare 5 m / sekondë.

Diellëzimi. Zona ka mbi 2627 orë diell / vit, janari ka rreth 121 orë / vit dhe korriki rreth 357 orë / vit.

Zona ka pasuri të mëdha klimatike, që shprehen në pasuritë e konsiderueshme termike: vlera të larta të temperaturave mesatare, zgjatjen e madhe e periudhës me temperature  $\geq 10^{\circ}\text{C}$ , në rastet e rralla me ngrica dhe periudhën e shkurtër të shfaqjes së tyre. Në dimër deri  $7^{\circ}\text{C}$  deri në  $2^{\circ}\text{C}$ , në pranverë  $18^{\circ}\text{C}$ , në verë  $30^{\circ}\text{C}$  dhe në vjeshtë  $17.3^{\circ}\text{C}$ .

Pasuritë pluviometrike: mesatarisht mbi 1250 litra për  $\text{m}^2$  të sipërfaqes, vlerat e larta të diellëzimit me rreth 2600 orë në vit etj.

#### 3.2 Gjeomorfologjia

Ekosistemet kodrinore të rajonit nga pikëpamja gjeologo-tektonike bëjnë pjesë në Ultësirën Pranë - Adriatike. Kryesisht mosha gjeologjike e ekosistemeve kodrinore të rajonit daton që para 15 milion vjetësh (Serravalian).

Evolucioni gjeologo-tektonik që kanë ndjekur këto rajone, ka kushtëzuar dhe elementet strukturor si: monoklinale, antiklinale, sinklinale , etj.

Nga ana stratigrafike rajoni ndërtohet kryesisht nga depozitime Neogjenike. Moshat më të vjetra dhe më të reja gjeologjike të pranishme në rajon janë Burdigaliani, Langiani, Seravaliani, Tortoniani dhe Mesinian.

Copëtimi horizontal i relievit lëkundet nga 1-5 km / $\text{km}^2$ . Ato rriten në drejtim të pjesës qëndrore më të lartë të territoreve argjilore të zonës dhe pranë qendrave të banuara rurale.

Copëtimi vertikal i relievit merr vlera të vogla deri nëmesatare, nga rreth 50 ne 200 m/ $\text{km}^2$ . Kjo lidhet me përbërjen litologjike dhe amplitudën jo të madhe të lëvizjeve

ngritëse neotektonike. Vlerat më të vogla i takojmë në rrethinat e zonës, sidomos në rrethinën fushore lindore dhe perendimore, ndërsa në atë jugore dhe veriore kanë shtrirje shumë më të kufizuar. Vlerat më të mëdha takohen në qendrën më të lartë të zonës dhe sidomos përgjatë fronteve të kuesteve apo kreshtave monoklinale.

Pjerrësia e shpateve merr vlera të ndryshme, më të mëdha (rreth 20-30 %) në shpatet e sektorit jugor dhe verior si dhe në frontet e kuesteve e kreshtave monoklinale, ndërsa vlerat më të ulta (deri në 10-15 %) takohen në rrethinat, sidomos perëndimore dhe lindore dhe në pjesën e poshtme të pellgjeve lumore të zhvilluara në depozitime argjilore.

Përqindjen më të madhe e zënë shpatet me orientim perëndimor së bashku me shpatet jugore dhe jugperendimore. Ato janë edhe më të ngrohtë, më të dritësuar dhe përbëjnë oferta të rëndësishme për shfrytëzimin e tyre për vendosjen e qendrave turistike apo kultivimin e bimëve termofile dhe heliofile.

Në këtë zonë përhapjen më të madhe e ka relievi strukturoro-eroziv dhe erozivo-denudues, të cilët ndërthuren në rrethinat edhe me forma të veçanta të relievit lumor.

Relievi strukturoro - eroziv, i lidhur me strukturën monoklinale dhe ndërthurjen e formacioneve me fortësi të ndryshme, përbehet nga disa kreshta monoklinale, kueste, sipërfaqe dhe lugina strukturore.

Relievi eroziv është i lidhur me proceset erozivo – denuduese, të cilat janë ndër faktorët kryesorë aktual që luajnë rol të rëndësishëm në modelimin e relievit. Intensiteti i tyre është i lidhur me kushtet e favorshme natyrore për zhvillimin e proceseve të erozionit dhe shpatit. Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre ka luajtur aktiviteti i njeriut mbi mjedisin dhe sidomos mbi bimësinë dhe tokat në veçanti.

### **3.3 Rezervat ujore**

Ndërthurja e pakove ranore e konglomeratike me ato argjilore i ka dhënë mundësi grumbullimit në sasira të konsiderueshme të ujrave nëntokesorë (akuiferet e Tortonianit, Mesinianit dhe Kuaternarit). Për këtë flasin pusët e shumta të hapura kohët e fundit nga vete fermeret dhe pusët e thella të hapura nga hidrogeologjia para vitit 1990, që furnizonin të gjitha qendrat e banuara me

ujë të pijshëm nëpërmjet ujësjellsave të ndërtuara në vite të ndryshëm. Për fat të keq këta ujësjellsa aktualisht nuk funksionojnë, prandaj edhe fermerët janë detyruar të hapin vetë puse të cekët (deri 10 m) për të siguruar ujin për nevojat e tyre. Kjo pasuri jo e vogël, në kushtet kur në sipërfaqe, siç theksuam, rezervat ujore janë tepër të kufizuara, duhet të vleresohet në strategjitë dhe planet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.

### **3.4 Tokat**

Tokat në këtë zonë janë të hinjta kafe dhe të kafenjta. Ato shtrihen në formën e brezave vertikale deri në lartësitë më të mëdha të zonës.

Ky ekosistem zë një pjesë të mirë të kësaj hapësire dhe në pjesën më të madhe shtrihet në zonën e ulët dhe kryesisht pranë zonave të banuara. Ai përfaqësohet

kryesisht nga tokat e mbjella me kultura të ndryshme bujqësore dhe nga pemët drufutrore të cilat janë mjaft të përhapura në këtë hapësirë.

Flora e tokave të kultivura është në përgjithësi e varfër dhe monofite, e përfaqësuar kryesisht nga të lashtat dhe kulturat prashitëse.

Kultura e druveve frutore në këtë hapësirë zë një sipërfaqe të konsiderueshme dhe është e përhapur pothuajse në të gjithë zonën, nga lartësitë 100-400 m.

### **3.5 Biodiversiteti**

#### **3.5.1 Flora**

Fizionomia floristike e kësaj zone përcaktohet nga shkurreta me gjethe gjithnjë të blerta dhe nga shkurreta gjethe rënëse. Në tërësi në zonë vrojtohen afro 350 lloje bimësh të shperndara në 196 Gjini dhe 60 Familje. Një pjesë e madhe syresh janë me rendësi ekonomike si bimë mjeksore, mjaltore, regjëse, helmuese, ushqimore dhe foragjere.

### 3.5.1.1 Bimësia ujore

Bimësia ujore e klasës Phragmitetalia, ku shoqërimi më kryesor është ai me kallamishten (*Phragmites australis*). Një vend të rëndësishëm në vegjetacionin e zones Vore-Preze zënë pyjet higrofile, të cilët i përkasin kryesisht klasave Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea. Në zonat fushore ku rrjedha e lumit është më e qetë, në mjedise me toka aluvionale ranore-argjilore, të cilat përmblyhen nga uji herë pas here gjatë vitit, dominon shoqërimi i verriut të zi. Në katin drunor, përveç *Alnus glutinosa* e *Fraxinus angustifolia*, takohen edhe *Ulmus minor*, *Populus alba* etj.

Në këto basene ujëmbledhës rritet një bimësi ujëdashëse dhe tepër interesante. Në brendësi të këtyre baseneve ndodhen disa lloje algash makrofite të gjelbërta si dhe disa bimë fanerogame.

### 3.6.1.2 Bimësia e shkurretave mesdhetare

Shkurretat mesdhetare janë një nga elementët kryesorë përbërës të zonës së makjes. Ato janë të shtrira pothuajse në të gjithë hapësirën dhe kryesisht të vendosura në pjesën e ulët të saj nga lartësia 100- 300 m mbi sipërfaqen e detit. Shkorretat mesdhetare në këtë hapësirë përfaqësojnë pjesën më kryesore të mbulesës bimore. Veçanërisht pjesa më e madhe e formacionit të makjes ndodhet në pjesën lindore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të zonës. Kjo lloj bimësie vesh shpatet e kësaj hapësire. Bimësia e kësaj zone përfaqësohet nga *Makia* që është formacioni më karakteristik i bimësisë tipike mesdhetare.

### 3.6.2 Fauna

Numri i Amfibeve të zonës është 10, afro 60% e llojeve të Amfibëve që jetojnë në Shqipëri. Ndërsa numri i reptileve të vrojtuar deri më sot është 25 lloje, rreth 70% të Reptilofaunes që takohet në Shqipëri. Numri i Amfibëve dhe Reptileve konsiderohet i lartë dhe shpreh gjithashtu shkallën e lartë të biodiversitetit të zonës.

Një numër i lartë llojesh është i rrezikuar në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga krahasimi i listës të llojeve të Amfibëve e Reptilëve me

listën e kuqe të Shqipërisë (Libri i Kuq, 1997) dhe anekset e disa konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë, rezulton së një numër i konsiderueshem i këtyre llojeve, të pranishme në zonat kodrinore Tiranë-Durrës, u perkasin llojeve të rrezikuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Kjo dëshmon për rëndësinë e zonës në studim në nivel kombëtar, Mesdhetar e më gjerë. Duhet theksuar se dhjetra ujëmbledhesit e ndërtuar në këtë zonë si dhe hapja e shumë kanaleve vaditës kane krijuar kushte mjaft të favorshme për të gjitha llojet e amfibëve.

#### **4. Të dhëna mbi procesin e prodhimit te betonit dhe fraksionimin e inerteve.**

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria eshte : Linje frksionim inerteve dhe prodhim betony  
Kapaciteti perpunues 75 T/h

Adresa e shoqerise : fshati Cerkez-Morine, Komuna Zall-Herr, Tirane,Qarku Tirane.

Nr. Kontaktit : Shkelqim Kupa 0682008338

Per te realizuar kete projekt subjekti ka montuar nje impiant te perpunimit te inerteve me lende te pare gurin gelqeror si dhe impiantin per prodhimin e betonit me lende te pare inertet , cimenton,aditiv dhe ujin.

Pershkrimi I impiantit dhe proceset qe ndodhin ne te.

Impianti I Inerteve:

- Bunker per pranimin e inerteve
- Transportier me pllaka
- Ushqyes(dozator)
- Thyers me nofull
- Thyers me çekiç
- Transportier me shirit
- Shosha klasifikimi

Impianti I betonit

Ekspert i Mjedisit Ing. Hysen Doçi

- Bunker I inerteve dhe cementos
- Dy bunkerat, silloset
- Transportier
- Pajisjet e dozimit
- Pajisjet e komandimit automatic

Treguesit fiziko – mekanik dhe kimik te lendes se pare

Lenda e pare qe do te perdoret per prodhim betony do te jene inertet e perpunuara nga impianti dhe nga analizat e bere rezultojne keta tregues:

Ne aspektin litologjik perberja e inerteve eshte :

Gelqeror	45%
Ranor	40%
Magmatik	10%
Shkembej te tjere	5%

Perberja granulometrike e materialit qe do te shfrytezohet sipas analizave laboratorike eshte si me poshte:

Inerte me permasa mbi 30 mm	23.7%
Inerte me permasa 0-5 mm	30.3%
Inerte me permasa 5-12mm	25%
Inerte me permasa 12-30mm	21%

Lendet e para per perkatitjen e betonit dhe produktet perfundimtare

a-Perbersit e betonit marka 300

1- Cemento Portland 42.5R	Densiteti:	3.0gr/cm3
	Koha e ngrirjes	
	Fillimi	110 minuta
	Mbarimi	160 minuta
	Rezistenca 28 ditore	55.0 Mpa



2- Rere natyrale 0-3 mm	Pesha specifike	2.685 g/cm <sup>3</sup>
	Moduli I imtesise	3.1
	Pesha vellimore	1462
3- Rere betony 3-5 mm	Pesha specifike	2.690 g/cm <sup>3</sup>
	Moduli I imtesise	86
	Masa vellimore	463 kg/m <sup>3</sup>
4- Granil "1" (5-10) mm	Pesha specifike	2.695gr/cm <sup>3</sup>
	Moduli I imtesise	5.9
	Masa vellimore	15463 kg/m <sup>3</sup>
5- Granil"2" (10-20) mm	Pesha specifike	2.697gr/cm <sup>3</sup>
	Moduli I imtesise	7.29
	Masa vellimore	1506 kg/cm <sup>3</sup>

Per marken e betonit 300 p

1- Cimento	400kg/m <sup>3</sup>
2- Aditiv	2.125litra
3- Inerte	1862.5kg
4- Uji	143.7 litra
5- Lageshtia	6.50%
6- Pesha vellimore	2408kg/m <sup>3</sup>
7- Konsistenca	11.5cm
8- Raporti uji/cimento	0.373

## Autobetoniara



## Impianti i betonit

## Fraksionim inerteve



**SHTOJCA I - TE DHENA SPECIFIKE PER LENDET E PARA***Tabela 1, - Lendet e para*

	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdorni lende te para	X		Inerte , cemento
A perdorni materiale ndihmese	X		Adetiv
A perdorni perzierje materialesh		X	
A perdorni lende djegese (dhe/ose energji)	X		Perdoret energjia elektrike
A perdorni kimikate sintetike/laboratorike		X	
Lutemi rendisni materialet sipas volumeve qe do te perdoren			

*Tabela 2 - Perdorimi/sigurimi I energjise*

	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdoret energji	X		Perdoret energji elektrike ,burimi nga rrjeti Cez shperndarja TN=20kv.Nga kuadri I tensionit te ulet del linja ajrore TU.0.4kv
A prodhohet kjo energji ne territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera	X		Sigurohet nga rrjeti CEZ shperndarje dhe si burim reserve nga gjeneratori me fuqi 300kv
Konsumi I lendeve djegese per sigurimin e energjise ne se prodhohet ne impiant/instalim		X	
Informacion tjetër sqarues		X	

Tabela 3\_Konsumi i energjise dhe ujit

KONSUMI I ENERGJISE	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (kwh/g, t/g e te ngjashme)
Burimi	Linja se tensionit T.N.20KV
Energjia elektrike	$P_{efektive}=172KW.$
KONSUMI I UJIT	Konsumohet uje gjate procesit te prodhimit, vetem per pergatitjen e betonit
Burimi i furnizimit	Pus dhe linja e ujesjellesit
Burimi i furnizimit	—

## SHTOJCA II - TE DHENA SPECIFIKE PER SHKARKIMET NE MJEDIS DHE TRAJTIMIN E TYRE

### 1, Shkarkimet ne mjedis dhe mbetjet

#### 1,1, Shkarkimet ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer (nga oxhaqet)		X	
A ka shkarkime ne ajer (nga burime te shperndara)		X	
A ka erera te keqija nga shkarkimet		X	

## 1,2 Shkarkime te ujrave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujrave te ndotura	X		Uji teknologjik qe perdoret per prodhimin e betonit eshte l ndotur ,uji qe perdoret per larjen e autobetonierave grumbullohet ne depozita te vecanta dhe materiali l dekantuar dergohet ne vende te caktuara dhe perdoret per mbushje
A ka ujra te ndotura me natyre toksike		X	Normat e shkarkimeve industriale të ujrave jane si me poshte : - pH 6 -9 - COD 150 mg / liter. - lendet pezull 50 mg / liter. - cyanide total 1 mg / liter. - Cianid i lire 0.1 mg / liter. - Arsenik 0.1 mg / liter. - Kadmium 0.1 mg / liter. - Baker 0.5 mg / liter - Krom 0.1 mg / liter. - Merkur 0.01 mg / liter. - Plumb .2 mg / liter. - Nikel 0.5 mg / liter. - Zink 2 mg / liter. - Hekur 3.5 mg / liter. - Radium 700 mBq / liter( njesi matese për elementët radioactive).
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve	X		Ujrat teknologjik pasi pastrohen nga metjet e ngurta shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve .
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore	X		Ujrat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve
Jepni sasine e ujrave te ndotura (m3/dite)	Sasia e ujrave qe shkarkohen ne siperfaqe eshte 0.86 m3/dite		

**1,3 Zhurma & Vibracionet**

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)																				
A gjenerohen zhurma	X		<p>Gjate procesit te fraksionimit te inerteve dhe te prodhimit te betonit gjenerohet zhurma ne nivelet 100 - 110 dB. Zhurma vjen nga proceset e thyerjes se gureve nga makinertie levizese te ngarkim-shkarkimit</p> <p>Normat e ekspozimit në zhurmë</p> <table> <thead> <tr> <th>Kohëzgjatja</th> <th>Zhurma në dB:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>8orë</td> <td>85dB</td> </tr> <tr> <td>6orë</td> <td>92 dB</td> </tr> <tr> <td>4orë</td> <td>95 dB</td> </tr> <tr> <td>3orë</td> <td>97 dB</td> </tr> <tr> <td>2orë</td> <td>100 dB</td> </tr> <tr> <td>1-1.5orë</td> <td>102 dB</td> </tr> <tr> <td>1orë</td> <td>105 dB</td> </tr> <tr> <td>0.5orë</td> <td>110 dB</td> </tr> <tr> <td>0.25orë</td> <td>115 dB</td> </tr> </tbody> </table>	Kohëzgjatja	Zhurma në dB:	8orë	85dB	6orë	92 dB	4orë	95 dB	3orë	97 dB	2orë	100 dB	1-1.5orë	102 dB	1orë	105 dB	0.5orë	110 dB	0.25orë	115 dB
Kohëzgjatja	Zhurma në dB:																						
8orë	85dB																						
6orë	92 dB																						
4orë	95 dB																						
3orë	97 dB																						
2orë	100 dB																						
1-1.5orë	102 dB																						
1orë	105 dB																						
0.5orë	110 dB																						
0.25orë	115 dB																						
A gjenerohen vibracione		X	Te paperfillshme																				

**1,4 Mbetjet e ngurta**

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta	X		<p>Në proceset teknologjike te prodhimit te inerteve dhe betonit ( gjatë, ngarkimi e shkarkimit te materialeve në transport etj) krijohet pluhur. Efekti dëmtonjës i pluhurave kushtëzohet nga sasia, koha e qëndrimit të pluhurit në mushkëri lloji dhe dimensionet. Kemi pluhura me veprim helmonjës, me veprim ngacmues, alegjik, më veprim fibrogjen, me veprim fotodinamik, pluhura që kanë veti të ulin aftësinë</p>

			mbrojtëse të indit mushkëror ndaj infeksioneve e deri në pluhura me veprim kancerogjen. Pluhurat duhet të maten e kontrollohen edhe nga përbërje kimike të tyre.
A gjenerohen mbetje te ngurta te rrezikshme		X	
Te asgjesuara ne territorin e impiantit/instalimit		X	

Normat e lejuara për pluhurat në ajrin e frymëmarrjes, pa përmbajtje SiO<sub>2</sub> është si më poshtë

Nr	Llojet e pluhurave	Përqëndrimi i lejuar i këtij lloje pluhuri në ajër në mg/m <sup>3</sup>
1	Pluhur azbesti	2
2	Pluhur çimento-argjile	5
3	Pluhur qymyri	5
4	Oksid hekuri	5
5	Nikel dhe oksidet e tij	0.5

Normat e lejuara për pluhurat në ajrin e frymëmarrjes me përmbajtje SiO<sub>2</sub> janë si në tabelë :

Nr	Përmbajtja e SiO <sub>2</sub> në % për pluhurat e ajrit të ambientit	Norma e lejuar e këtij lloji pluhuri në mg/m <sup>3</sup>
1	0.5	5.00
2	10	3.80
3	20	3.70
4	30	3.65
5	40	3.60
6	50	3.55
7	Mbi 50%	3.40

#### 1,5, Burimet e shkarkimit ne ajer

Emertimi I shkarkuesit	
Pershkrimi	Ka shkarkime ne ajer ne atmosferen e linjave te prodhimit ne procesin e prodhimit te betonit dhe inerteve , ngarkimit dhe shkarkimit te materialeve .
Koordinatat	Frontet ne te cilat ndodhin keto shkarkime jane stacionare dhe konkretisht ne pajisjet e thyerjes dhe coptimit , ne pajisjen e klasifikimit (sita ) transportjer .
Informacion per oxhakun	-
Diametri: Lartesia nga toka	-

Ekspert i Mjedisit Ing. Hysen Doçi

Data e venies ne pune	Fillimi I procesit te prodhimit me marrjen e lejes se shfrytezimit
-----------------------	--

### 1,6 Fluksi dhe kohezgjatja e shkarkimeve (per cdo pike/burim shkarkimi) ne ajer

Rrjedha (volumi i shkarkuar)			
Vlera mesatare ne dite	N mg/d 30	Max/dite 50	Mg /d —
Vlera maksimale ne ore	N mg/ ore 3.75	Rrjedha min 2	m.s-1 —
Faktore te tjere	Nuk ka faktore te tjere ndikues		
Temperatura	°C(max) 18	°C(min) 15	°C(mes) 16.5
Burimet e djegies	Nuk ka burime djegie		
Vlerat e volumit te dhena si :	___ l thate	___ l njome	___ % O2

### 1,7 Karakteristikat e shkarkimit ne ajer

Paramet ri	Perpara trajtimit				Perskri m l shkurter l trajtimit	Pas trajtimit (filtra etj..)			
	mg/Nm <sup>3</sup>		kg/ore			mg/Nm <sup>3</sup>		kg/ore	
	Mes	Maks	Mes	Maks		Mes	Maks	Mes	Maks
—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
—	—	—	—	—	—	—	—	—	—

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprejra e punes)

Kohezgjatja e shkarkimit (mesatare)	Min/ore	ore/dite	dite/vit
	—	—	—

### 1,8 Clirimi i zhurmes ne mjedis

Mjediset/Godinat e instalimit/impianit	Sistemi koordinativ	Niveli i zhurmes dB(A)		
		L(A)	L(A)	L(A)
Vendndodhja 1	—	—	—	—
Vendndodhja 2	—	—	—	—



Vendndodhjet e ndjeshme te zhurmes				
Vendndodhja 1	—	—	—	—
Vendndodhja 2	—	—	—	—

## 2, Shkarkimet e ujrave te ndotur

### 1, Pika e shkarkimit

Nr. Ref i pikes se shkarkimit (numri referues duhet te jete I njejte me numrin e shkruar ne harten e instalimit/impiantit)	Kanali kryesor I kullimit
Burimi i shkarkimit	Ujerat teknologjik
Vendndodhja	Ne autobetoniera
Koordinatat ne sistemin shteteror	Y = 43----- X = 45-----
Emri/Emertimi i marresit (lumit, liqenit)	Kanali kryesor

### 2, Informacion i detajuar per shkarkimet e lengeta

Sasia e shkarkuar		Nuk ka shkarkime te tjera te lengeta	
Mesatare / dite	m <sup>3</sup>	Sasia maksimale / ore	m <sup>3</sup>
Sasia maksimale / ore	m <sup>3</sup>	—	—

Jepni periudhen ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke perfshire variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qene venia ne pune dhe/ose nderprejra e punes)

Periudha e shkarkimit (mesatare)	Min/ore	ore/dite	dite/vit
	Nuk ka shkarkime te lengeta		

### 3, Karakteristikat e shkarkimeve te ujrave te ndotura

Parametri	Perpara trajtimit		Nga vendi I lirimit/leshimit pas shkarkimit					
	Mesatarja max. e vleres/ore (mg/l)	Mesatarja max. e vleres ditore (mg/l)	kg/dite	kg/vit	Vlera mesatare max. ne ore (mg/l)	Vlera ditore e mesatares max. (mg/l)	kg/dite	kg/vit
SiO <sub>2</sub>	3,6	28,8	0,0000288	0,010512	3,6	28,8	0,0000288	0,010512

#### a. Informacion per cilesine e ajrit dhe ujrave siperfaqsores ne zonen e veprimtarise ku do te kryhen shkarkimet ne mjedis

Faktorët fizik që ndikojnë në shëndetin e punonjësve duhet të mbahen gjithnjë parasysh nga zotëruesit e lejes minerare. Të ftohtit dhe lagështira në mjediset e punës shkaktojnë nefrite acute dhe hemoglobinuri "afrigore." Temperaturë e lartë çon në çrregullime hidroelektrolitike që ndikojnë në dëmtimin e reneve dhe shpesh mbizotëron infeksioni në mushkëri. Kombinimi i temperaturës lagështirës relative dhe shpejtësisë së ajrit është vendimtare për të mbajtur kushte normale në punë.

***Per monitorimin e mikroklimës disponohen aparatura për testimin gazor , për matjen e temperatures, presionit, lagështirës relative, për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së rrymave të ajrit, të eliminimit të pluhurave duke perdorur dhe sperkatjen me uje.***

Lidhja midis shpejtësisë së ajrit, temperaturës dhe lagështirës relative jepen në tableën e mëposhtme:

Shpejtësia e ajrit në m/sek	Temperatura e lejuar °C për lagështi		
	60-75 %	76-90%	90%
Deri 0.25	24	23	22
Deri 0.5	25	24	23
Deri 1	26	25	24
2 dhe më shumë	26	26	25

#### 4.2 Mbetjet teknologjike

Mbetjet teknologjike janë në sasira te konsiderushme . por shoqëria e ka zgjidhur ne menyre ligjore,pasi ka kontrate me Komunen Zall-Herr per grumbullimin dhe heqjen e tyre.

- Mbetje ambalazhi ( karton, plastike )

Gjithashtu shoqëria “ **Korabi 2007** ” Sh.p.k ka lidhur kontratë me Komunen për marrjen e mbeturinave nga koshat që ndodhen pranë subjektit .

### **4.3 Infrastruktura inxhinjrike**

- Uji i pijshëm nga rrjeti kryesor i zonës
- Energjia elektrike, linjë e veçantë nga CEZ
- Ujrat e shkarkuara derdhen në kanalizimin e zonës

### **4.4 Energjia dhe burime të tjera për konsum**

- Energjia elektrike

Energjia elektrike do të përdoret për të vënë në punë elektromotorrët e makinerive dhe pajisjeve , sistemin e ventilimit, ndriçim, etj.Ndriçimi i ambjenteve të objektit do të behet nga energjia elektrike.

Ndriçimi i jashtëm do të mbulojë të gjithë sheshin përpara objektit dhe sipërfaqet e gjelbëruara. Ky ndriçim do të bëhet me prozhektorë të vendosur në shtylla metalike me lartësi 10 m.

### **4.7 Sigurimi teknik i objektit dhe i punonjësve**

Objekti i shoqërisë “**Korabi 2007** ” Sh.p.k, me destinacion prodhimin e inerteve dhe betonit , është një objekt i ndërtuar me planimetri të rregullt duke respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tij. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të shkarkimit të atomjeteve, magazinimit, volume të mëdha ruajtje dhe mjedise të mëdha për kryerjen e aktiviteteve të tjera të administratës, ekipit të mirëmbajtjes, dhomat higjienike, dhomat e zhveshjes, tualetet, etj.

Janë ndërtuar kanalizime të rregullta për shkarkimet e ujrave që përdoren në proceset e punës. Rrjeti elektrik i objektit është i ri (linjë e veçantë), gjatë zbatimit të projektit për këtë rrjet është patur parasysh që të relizohen tokëzimet e nevojshme për të gjitha makineritë dhe pajisjet e prodhimit.

Për rastet e mundëshme të rënies së zjarrit, në objekt janë vendosur shuarësit e zjarrit me gaz shkumues. Punonjësit e linjës janë instruktuar për rastet e rënies së zjarrit si dhe për rastet e aksidenteve në punë. Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse, si punonjës te industrise ndertimit .

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në objekt realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik për punimet e ndertimi.
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektorati i Higjenës së Punës.

Operacionet e punës kërkojnë përdorimin e veshjeve personale speciale rroba pune, kepuce , syze, maska etj Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë dy detyrat kryesore të stafit drejtues dhe i punonjësve.

Një ndër kërkesat e shoqërisë “**Korabi 2007** ” Sh.p.k për makineritë e pajisjet e punes është që rreziku i aksidenteve në punë dhe prekja e shëndetit nga agjentët e ndryshëm fizikë apo kimikë të jetë në nivelet më minimale. Kjo do të bëjë të mundur që të ulen në minimum pasojat që vijnë nga proceset e ndryshme të punes.

Masat kryesore të sigurimit teknik do të jenë:

- Para fillimit të punës punëtorët do të veshin rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse gjatë punës
- Mbetjet do të evakuohen rregullisht për në vendin e depozitimit të përkohshem .
- Realizimi i sistemit të aspirimit i tërë mjediseve të punës

Stafi i linjes është si më poshtë:

Administrator / Menaxher	1
Teknolog / Magazinier	1
Financier	1
Punëtorë	30
Arkëtar	1
Roje	kontratë me kompani private

Do të punohet me 1 turn në ditë. 8 orë në ditë. 6 ditë në javë.

## **5. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis i aktivitetit të Prodhimit të inerteve dhe betonit.**

Objekti i shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k me destinacion prodhimin e inerteve dhe betonit duke qënë se kapaciteti i prodhimit varet nga kërkesat e tregut të konsumatorëve dhe tregtarëve për këto produkte. Punon me kapacitet të plotë.

Zakonisht ajo punon me një turn, gjatë orëve të paradites dhe drekës, nga ora 8<sup>00</sup> e mëngjësit deri në orën 16<sup>00</sup> të pasdites. Në raste të rralla punon edhe në orët e mbasdites vetëm me pak punëtorë. Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka patur ankesa apo shqetësime nga banorët e zones perreth apo nga aktivitetet e tjera që ndodhen pranë kësaj linje. Gjithashtu edhe Komuna është dakort për t’u zhvilluar ky aktivitet.

Kështu janë ë marrë masa teknike efikase për zgjidhjen e problemeve me ndikim negativ në mjedisin rrethues (sado të vogla qofshin ato).

- Të gjitha paisjet, janë montuar me të gjitha garancitë për nivele të zhurmave apo vibracioneve.

- Ujrat e bardha teknologjike të objektit dhe ato të larges së dyshemesë shkarkojnë në pusetat brenda territorit të objektit, të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha të zonës, pa shkaktuar probleme, ndërsa ujrat e zeza shkarkojnë në kanalizimet e ujrave të zeza. Territori përreth objektit është i shtruar dhe ka sheshe për parkimin e mjeteve dhe gjelbërim, ky ambient është gjithmon i pastruar nga hedhurinat apo ndonjë mbetje teknologjike.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është përgatitur si pjesë e dokumentacionit që duhet për të marrë miratimet e zhvillimit të aktivitetit nga institucionet përkatëse.

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr 10431 date 09.06.2011

“Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ai synon aspektet mjedisore të aktivitetit dhe ndikimet e mundshme në mjedis si rezultat i zhvillimit të tij.

Në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis shoqëria “**Korabi 2007**” Sh.p.k jep informacionin e duhur:

- Për zonën e zgjedhur e destinuar për aktivitetin industrial, zona Maminas-Karpen ,Komuna Maminas
- Për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me kërkesat mjedisore
- Kriteret për zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të inerteve dhe betonit do të jenë në përputhje me kriteret e mbrojtjes së mjedisit.

## 6. Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë. Nuk parashikohet të ketë ujara të ndotura teknologjike. Ujrat që do të përdoren për pastrimin e objektit dhe tualetet do të derdhen në sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë mbetje të ngurta që do të shkarkohen në tokë.

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave. Gazet e djegjes së lëndëve djegëse janë minimale dhe të pakonsiderueshme.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës, pasi ajo është shumë e varfër, pasi kjo zone ka vite që është një zonë industriale.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjësve të shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të aromave të ndryshme në ambientet përreth objektit e as në brendësi të tij.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitim të rrezikut nga zjarri. Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.
- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k

Shoqëria “**Korabi 2007**” Sh.p.k ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit shqipëtar.

## **7. Masat zbutëse**

### **7.1 Mbetjet**

Ambjentet e shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k pastrohen rregullisht si brenda, ashtu edhe rrethinat e jashtme dhe mbetjet urbane të akumuluar depozitohen në koshat më të afërta të plehrave.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë mbetje të ngurta që do të shkarkohen në tokë dhe as prodhim të mbetjeve të rrezikshme.

### **7.2 Ndotja nga karburantet**

Vend parkimet e automjeteve pastrohen rregullisht me solucione të ndryshme, pasi aty mund të kemi herë pas here rrjedhje të karburanteve ose likuideve të ndryshme. Gjithashtu parkimet janë të pajisur me puseta ku grumbullohet uji që



përdoret për larjen e ambjentit. Dherat e akululuara në këto puseta mbledhet dhe dërgohen në vendet e caktuara.

#### **7.4 Zhurmat**

Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjesve të shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k dhe as në shëndetin e personave që jetojnë apo punojnë në ambjentet përreth .

#### **7.5 Gjelbërimi**

Territori përreth objektit është i shtruar dhe ka sheshe për parkimin e mjeteve dhe gjelbërim, ky ambjent është gjithmonë i pastruar nga hedhurinat apo ndonjë mbetje teknologjike.

Sheshi përpara dhe anësor është i dekoruar me bimë të ndryshme dekorative, gjithashtu parkingu është i rrethuar me bimë dekoruese.

#### **7.6 Kanalizimet**

Ujrat e bardha teknologjike të objektit dhe ato të larjes së makinave shkarkojnë në pusetat brenda territorit të objektit, të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha të zonës, pa shkaktuar probleme, ndërsa ujrat e zeza shkarkojnë në kanalizimet e ujrave të zeza të Komune

#### **7.7 Përdorimi eficient i ujit dhe energjisë**

Punonjësit e Shoqërisë janë udhëzuar të bëjnë një përdorim të duhur të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Ata janë tepër të kujdesshëm për një përdorim sa më të përshtatshëm të këtyre dy burimeve.

## 7.8 Masat mbrojtëse për punonjësit

Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse, si punonjës së industrisë ndertimit

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik për punimet ne ndertim
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektoriati i Higjenës së Punës
- Garancinë e produkteve si të padëmshme për shëndetin e punëtorëve në të gjitha fazat e punës me to.

Operacionet e punës në mjedist e linjes kërkojnë përdorimin e veshjeve personale per mbrojtjen e tyre ne pune.. Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë dy detyrat kryesore të stafit drejtues dhe i punonjësve.

Një ndër kërkesat e shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k për makineritë e dhe pajisjet , është që rreziku i aksidenteve në punë dhe prekja e shëndetit nga agjentët e ndryshëm fizikë apo kimikë të jetë në nivelet më minimale. Kjo do të bëjë të mundur që të ulen në minimum pasojat që vijnë nga proceset e ndryshme të perpunimit, prodhimit, transportit dhe magazinimit të produkteve.

### **Masat kryesore të sigurimit teknik do të jenë:**

- Para fillimit të punës punëtorët do të veshin rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse gjatë punës
- Mbetjet teknologjike do të evakuohen rregullisht për në vendin e depozitimit të përkohshem .

## 8. Programi i monitorimit

Potencialet negative të përmendura më sipër mund të minimizohen duke marrë një sërë masash të cilat çojnë në përmisimin dhe reduktimin e ndikimit në mjedis.

1. Sasitë e mbetjeve sipas llojit, do të maten dhe klasifikohen sipas Katalogut Shqipëtar të Mbetjeve.
2. Derdhjet e karburanteve dhe sasitë e detergjentëve që do të përdoren në ambientet e jashtëme dhe të brendëshme të linjes do të monitorohen.

Duke qenë se projekti nuk emeton / shkarrkon në mjedis substanca apo lëndë në nivele të tilla që të kërkojnë përdorimin e instrumentave të posatshëm të monitorimit. Monitorimi i veprimitarisë do të jetë i thjeshtë dhe i bazuar më shumë në vëzhgimin me shqisa të operacioneve dhe mënyrës së realizimit të tyre dhe ndonjë ngjarje aksidentale që mund të sjellë pasoja negative në mjedis.

### 1.Trajtimi I ndotjes

Lloji I shkarkimit/ndotjes (ne ajer, toke , uje	Pershkrimi I trajtimit

## 2. Menaxhimi I mbetjeve

Material mbetjesh	Nr nga rregullorja per Kategorine e Mbetjeve , duke perfshire listat	Vendi kryesor I gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjesimi ne instalim/impiant (Metoda dhe vendndodhja )	Trajtimi , rekrutimi , riciklimi ose asgjesimi jashte instalim/impiant (Metoda dhe vendndodhja )
			Ton/muaj	m3/muaj		
			0.2 ton			

## 3. Programi I vetmonitorimit te shkarkimeve

Vendndodhja e monitorimit/Koordinatat ne Sistemin e koordinimit UTM :

Perimetri	Rezultatet (mg/l ose mg/m3)				Metoda e marrjes se mostres	Qellimi/arsyeja e vlersimit analitik	Metoda analitike/teknika
	Data	Data	Data	Data			

## 9. Konkluzione

Nga sa është verifikuar dhe matur në vend dhe që pasqyrohet në këtë raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së mësipërme rezulton së ushtrimi i këtij aktivitetit bëhet konform të gjitha rregullave të sipërmarrjes së lirë të biznesit privat vendas.

Ekspert i Mjedisit Ing. Hysen Doçi

Me miratimin e veprimtarisë nga organet shtetërore, sipas ligjeve në fuqi, Shoqëria angzohet dhe i ka marrë të gjitha masat për të ushtruar veprimtarinë e saj sipas kriterëve ligjore dhe teknike të vendosura nga këto organe.

Përsa i takon ndikimit në mjedis ai është parashikuar dhe vlerësuar me një objektivizëm. Në materialin e mësipërm shihet qarte se ky është një ndikim i vogel , por gjithsesi shoqëria “**Korabi 2007**” Sh.p.k është e ndërgjegjshme se sado i vogel ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen prepjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlere minimale.

Nga sa u tha më sipër nxjerrim si përfundim se:

- Objekti ndodhet në një zonë rurale ,për më tepër një zonë e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti, i cili do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të zonës.
- Teknologjia që zbatohet është bashkëkohore.
- Në veçanti, nga analiza që i është kryer në tërësi këtij aktiviteti nuk konstatohen ndikime të veçanta mjedisore si në, florë, fauna, ujë, ajër dhe tokë. Si përfundim mund të themi se aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën përreth.

Nga të gjitha problemet që janë trajtuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nxjerrim përfundimet e mëposhtëme:

- Aktiviteti i prodhimit të inerteve dhe betonit nuk do të ketë ndikime negative në mjedis.
- Linja industriale ruan distancë optimale largësi nga zonat e banuara dhe ndodhet në një zonë të përshtatshme , gjë që nuk sjell ndikim negativ për popullatën.
- Ndodhet në zonë më rrjet rrugor të kompletuar.

- Gjithashtu në zonën ë zgjedhur nga investitori ekzistojnë linjat elektrike, sistemi i kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, tubacionet e ujësjellësit, etj.
- Funkcionimi i ketij aktiviteti do të ndikojë për zhvillimin e zonës, duke punësuar disa punëtorë e specialist nga zonat përreth objektit të shoqërisë “**Korabi 2007**” Sh.p.k, gjë që do të ndikojë në një farë mënyre në zbutjen e problemeve sociale dhe të zonës përreth.

Përgatiti raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:

Specialist i VNM dhe auditimit mjedisor

Ing. Pasurimit te Mineraleve **HYSEN DOÇI**